



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3813/prot. 1

Tiranë, më 16.6.2023

UDHËZIM

Nr. 10, datë 16.6.2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015, "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. Pika 3, e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

"3. Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj të paktën në nivelin B1. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj të paktën në nivelin B2. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre të brendshme nivelin e gjuhës së huaj, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë dhe të tretë, në përputhje me nivelet e cituara në këtë pikë të udhëzimit."

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

EVIS KUSHI

